

Kalendar i konsultimit publik

Titulli i Projekt-aktit : PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjete e nentemije) M2.

Propozuesi : Bashkia Pogradec.

Sqarime për projekt-aktin : Duke qënë se është paraqitur Projekt-Vendimi me titull: PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjete e nentemije) M2, në mbështetje të plotë të nenëve 18, pika 1), 54 e Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Pogradec për "Konsultimin Publik" miratuar me VKB nr. 42, datë 05/03/2020, si dhe Rregullores për ankesat, kërkesat dhe peticionet iniciativat qytetare të Këshillit të Bashkisë Pogradec, miratuar me VKB nr. 67, datë 01/06/2020, Kryesia e Këshillit me vendim nr 19, datë 30/07/2025, vendosi kalimin e kësaj iniciative për konsultim publik me të gjitha grupet e interesit

Grupet që do të konsultohen: Takim me të gjithë banorët e fshatit Cërravë .

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1.	Takim me banorët e Njesisë Administrative Cërravë .	18.08.2025	Cërravë	11:00	Takim publik	Diskutime.

Kryetare e Komisionit: Silvana Palaj

Sekretare e Këshillit: Jona Bojko

